



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 885/3 Prot.

Tiranë, më 23 .06 . 2025

V E N D I M

Nr. 150, Datë 23 .06 . 2025

Bazuar në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹ është regjistruar ankesa nr. 139, datë 05.06.2025, e paraqitur nga znj. F.Z, kundër znj. E.B, në cilësinë si drejtuese e institucionit të Avokatit të Popullit, me pretendimin për diskriminim për “*çdo shkak tjetër*”².

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “*Fillimi i diskriminimit ndaj personit tim ka nisur në janar 2023, kur vendosa të kandidoja për komisionere në institucionin ku ushtroj detyrën prej vitit 2016. Ishte e drejta ime të kandidoja dhe të kërkoja ecurinë në karrierë, kështu depozitova dokumentet në protokoll, për 2 nga 3 vendet që ishin shpallur nga institucioni, pasi plotësoja kriteret ligjore.*

Avokatja nuk ishte dakord me kandidimin tim. Kam kërkuar takim me të, duke dashur t’i shpjegoj të drejtën për të ecur në karrierë dhe njëkohësisht duke kërkuar edhe mbështetjen e saj si

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

² Lidhur me ecurinë në karriere të ankuses, pas kandidimit si komisionere në institucionin e Avokatit të Popullit.

titullare. Ajo nga ana e saj ma preu shkurt se do të mbështeste persona të tjerë dhe unë nuk duhet t'i kisha paraqitur dokumentet, pasi mund t'i prishja interesat e saj, për njerëzit që donte të promovoheshin si komisionerë.

Ma bëri të qartë se duhet të tërhiqesha, por unë vendosa të ndjek rrugën time dhe nuk u tërhoqa nga ky proces. Pas paraqitjes në Komisionin e vlerësimit në institucion, me qëllim u rendita në vendet e fundit të listës që iu dërgua Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Pavarësisht renditjes së paraqitur nga institucioni i Avokatit të Popullit, bëra një paraqitje dinjitoze në seancën dëgjimore në Komisionin e Ligjeve, si kandidaturre e kompletuar dhe u vendosa si kandidate për t'u votuar në dy seksionet ku kisha aplikuar në seancën plenare të datës 04.04.2024. Në fund të procesit të votimit, pavarësisht votimit nga një numër i konsiderueshëm deputetësh, nuk u zgjodha komisionere.

Vijova punën time me përkushtim, sikurse e kisha bërë më parë në institucionin e Avokatit të Popullit. Pavarësisht kësaj, ishte e dukshme se titullarja nuk e pranonte mosbindjen time për tërheqjen nga kandidimi.

Në muajin gusht të vitit 2024, ditët e fundit të pushimit vjetor, jam sëmure rëndë dhe pas fillimit të kurimit nga mjeku i familjes, më janë dhënë 3 ditë raport për t'u recuperuar. Raport i cili është dërguar në rrugë elektronike edhe në institucion, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Duket se ky raport nuk ka qenë i mjaftueshëm, por drejtuesit e institucionit kryesisht kanë nisur hetim ndaj personit tim dhe mjekut të familjes me shkresën nr. 411, datë 13.08.2024, drejtuar institucionit Shëndetësor nr. 8, Tiranë dhe për dijeni Drejtorit të Operatorit të Kujdesit Shëndetësor me lëndë: “Kërkesë për verifikim të raportit për paaftësinë në punë për sëmundje të përgjithshme që paguhen nga punëdhënësi”.

Edhe pse nga mjeku i familjes është dërguar nëpërmjet sistemit elektronik raporti mjekësor i lëshuar me datë 12.09.2024, për 3 ditë me diagnozën përkatëse, kjo nuk ka mjaftuar për të ngritur “dyshime të arsyeshme” aspak të justifikuara, në shkelje të rëndë të parashikimeve kushtetuese, të të drejtave të njeriut, duke keqpërdorur ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, për të hetuar punonjësit e vetë institucionit të të drejtave të njeriut.

Pa asnjë arsye të qenësishme, duke uzurpuar kompetencat e institucionit të prokurorisë, është kërkuar të verifikohet punonjësja dhe mjekja. Janë kërkuar vënia në dispozicion e kopjes së regjistrit të vizitës, e çdo informacion që lidhet me këtë punonjëse, përfshirë recetën e kurimit, protokollin e ndjekur për trajtimin. Por, ajo që është më e rëndë akoma është kerkimi dhe vënia në dispozicion e pamjeve të kamerave të sigurisë së institucionit shëndetësor për datën 12.08.2024 ku të vërtetohet paraqitja e punonjësës për të marrë shërbimin shëndetësor, duke urdhëruar qendrën shëndetësore të vendosë në dispozicion dokumentacionin brenda 24 orëve.

Të gjitha këto veprime janë kryer në kundërshtim të plotë me nenin 130, të Kodit të Punës.

Në pamjet filmike të administruara nga Qendra Shëndetësore nr. 8, dërguar Avokatit të Popullit shfaqem unë, djali im dhe njerëz të tjerë që hyjnë për të marrë shërbim në këtë qendër. Në asnjë paragraf të shkresës së Avokatit të Popullit nuk përmendet ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Unë nuk jam njoftuar as nga institucioni ku punoj dhe as nga Qendra Shëndetësore nr. 8, për këto verifikime. Por, ata në bashkëpunim me Avokatin e Popullit, kanë administruar të dhënat e mia personale/sensitive, si dhe i kanë nxjerrë të dhënat e mbrojtura me ligj.

Aktivizimi i Avokatit të Popullit dhe Sekretarit të Përgjithshëm, pra të dy këta persona janë vënë në lëvizje që të gjejnë një shkak sado të vogël për të filluar një procedurë disiplinore. Është vijuar për një kohë të gjatë me provokime, biseda të përshkallëzuara dhe unë nga ana ime nuk kisha arsye të tërhiqesha nga mbrojtja e dinjitetit tim. Nuk ka asnjë indicie apo dokument të brendshëm në këtë institucion për të vënë në dyshim rrethanat mjekësore. Ndërkohë, që të tjerë nuk vijnë me muaj pa paraqitur as raporte mjekësore, por shkojnë me pushime.

Administrimi i pamjeve filmike të miat dhe të fëmijës tim në qendrën shëndetësore shfaqin hapur krijimin e një situate me paragjykim dhe dashakeqe.

Gjendja e mësipërme nuk ka ndaluar me kaq. Kjo sjellje abuzuese dhe përndjekëse është e përsëritur nga titullarja e institucionit, e cila në muajin dhjetor 2024, ka hyrë në mjedisin e zyrës, ku unë punoj, për të diskutuar mbi komentet që kishte për disa rekomandime që kisha punuar unë dhe dy koleget e zyrës, A.S dhe S.N. Gjatë diskutimit, i cili ka qenë i qetë nga ana ime, titullarja ka bërtitur dhe ka kaluar në fyerje personale, duke më thënë “që nuk mbush mirë”, shoqëruar edhe me gjeste nga ana e saj (që nënkuptonin se kisha probleme mendore). Kjo fyerje është dëgjuar dhe parë edhe nga dy kolegët e zyrës, të pranishëm në këtë moment. Pavarësisht faktit se jam ndjerë thellësisht e indinjuar për fjalët dhe veprimet, nuk ka pasur asnjë reagim nga ana ime, për të shmangur debatin me fjalë.

Ndërkohë, situata përsëritet në datën 12.05.2025, kur jam ndeshur rastësisht me titullaren e institucionit, në korridorin e katit të dytë, kur po dilja nga mjedisi i zyrës ku punoj. Pasi e kam përshëndetur “Mirëmëngjesi”, kam kërkuar të largohem. Por me ton ironik ajo më ka pyetur: “He moj F si u bëre?”. Unë iu përgjigja qetë: “Jam më mirë, gjëra që kalojnë. Mosqofshin të mëdha”. Pas kësaj përgjigjeje, titullarja, në prani të dy komisionerëve, tha: “Se kjo, e ka zakon që çdo dy javë merr raport”. Duke u ndjerë e prekur thellë për atë që unë përfaqësoj si punonjëse me eksperiencë e institucionit të Avokatit të Popullit, profesioniste, kam mbrojtur të drejtat e mia si nëpunëse civile, duke i kërkuar të shmangë situatën e paligjshmërisë. Kjo bisedë është dëgjuar edhe nga kolegu i zyrës A.S, dëshminë e të cilit e gjeni bashkëlidhur.

Aktualisht gjendem në situatën ku titullarja përveç provokimeve që shprehu se do të verifikojë përsëri raportet mjekësore dhe do të flasë ndryshe me mua, ka kërkuar fillimin e ecuresë disiplinore për shkelje të rregullave të etikës, si dhe në vijim vazhdimin e një tjetre ecurie disiplinore, sipas emailit të datës 13 maj 2025.

Me një vendim të marrë de facto që në datën 12 maj, ndaj personit tim, de jure ky vendim është marrë përpara seancës së shpalljes së vendimit të datës 29.05.2024 “Për marrjen e masës disiplinore në ngarkim të nëpunësit civil F.Z”.

Titullarja e institucionit, me dashje, harron të përmend në raportimin mbi ngjarjen, me email-in e datës 13.05.2025, provokimet që më ka bërë. Biles shkon edhe më tutje, duke administruar një deklaratë që në fakt është vlerësim psikologjik, i paligjshëm nga një punonjëse e institucionit, për të më nxjerrë, sikur paraqes probleme mendore.

Abuzimi verbal në vijimësi ndaj personit tim ka patur për qëllim poshtërimin në sy të personave të tjerë, për të ulur imazhin tim, duke krijuar përshtypjen se jam një person, që bën sikur është e sëmurë dhe për të më izoluar/veçuar në mjedisin e punës nga kolegët dhe stafi.

Është pikërisht kjo titullare ku në mbledhjen e datës 06.05.2025, të stafit të institucionit u kërkon ndihmëskomisionerëve të mos japin një mendim ndryshe për qasjen e tyre ndaj çështjeve që trajtojnë, pasi do ta heqë njërin prej tyre, pa respektuar asnjë procedurë ligjore dhe të vejë ta gjejë të drejtën gjykatave.

Pabarazia në këtë institucion ka kapur majat, ku një pjesë e marrin pushimin vjetor me detyrim përcaktim dhe përndiqen deri te raportet mjekësore në rast sëmundjeje, ndërsa të tjerët marrin leje më shumë se sa u takon dhe përgjatë gjithë vitit.

Kanë krijuar situata artificiale, duke përdorur deklarata të njerëzve të caktuar që përveçse nuk ishin prezentë, ngarkojnë fiktivisht imazhin tim sikur kam bërë sjellje të pahijshme. Për më tepër nuk më kanë dhënë të drejtën për t'u mbrojtur në një proces të paragjykuar, tërësisht subjektiv dhe të njëanshëm. Gjatë procesit disiplinor nuk më janë vënë në dispozicion as pamjet filmike të institucionit, duke cenuar të drejtën për t'u mbrojtur.

E drejta për të vënë në vend dinjitetin tim po manipulohet plotësisht me veprime konkrete të institucionit që nuk shmang paligjshmërinë, por përkundrazi i del edhe në mbrojtje.

Shqetësimet dhe veçimi që më kanë ardhur nga e gjithë kjo situatë kanë prekur jo vetëm mjedisin ku punoj, por më kanë ngarkuar edhe me stres të jashtëzakonshëm në jetën time familjare, si bashkëshorte dhe si nënë.

Me veprimet e tyre konkrete titullarja, Sekretari i Përgjithshëm dhe Eprori i drejtpërdrejtë kanë cenuar rëndë dinjitetin tim dhe kanë krijuar një mjedis frikësues, armiqësor, përçmues, poshtërues, për të vetmin fakt se kam kërkuar respektimin e të drejtave të mia si punonjëse e këtij institucioni.

Kjo sjellje, e titullares së institucionit, përbën shkelje të nenit 9, pika 2, të VKM nr. 874, datë 29.09.2021, ku parashikohet se: “Titullari i institucionit të administratës publike realizon me ndershmëri dhe përpikëri objektivat e ngarkuar nëpërmjet, sjelljes së duhur organizative, shfaq

sjellje të përshtatshme dhe të paanshme, duke shërbyer si model për nëpunësit, si dhe nxit zbatimin e standardeve më të larta në administratën publike”.

Kodi i Punës në nenet 32 dhe 33, përcakton shprehimisht detyrimin se punëdhënësi duhet të mbrojë punëmarrësin dhe personalitetin e tij, shëndetin mendor e fizik, të dhënat personale, etj.

Po ashtu, neni 5, i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, parashikon: “Administrimi i shërbimit civil udhëhiqet nga ligji dhe bazohet në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, si dhe garanton qëndrueshmërinë në detyrë të nëpunësit civil dhe vazhdimësinë e shërbimit civil”.

Neni 33 i po këtij ligji përcakton të drejtën e kushteve të përshtatshme të punës dhe të drejtën e mbrojtjes nga shteti. Nëse të kërkosh dhe të mbrosh të drejtat përpara titullarëve në një institucion që ka mision mbrojtjen e të drejtave, lirive themelore dhe interesave të ligjshëm të qytetarëve, përbën shkelje të etikës, atëherë po e kam shkelur.

Vlen të përmendim se ngacmimi moral është aq i pranishëm dhe serioz sa që organizatat ndërkombëtare në luftën ndaj këtij fenomeni, si Organizata Ndërkombëtare e Punës e konsiderojnë si dhunim të të drejtave themelore të të punësuarve, kërcënim ndaj sigurisë dhe shëndetit, diskriminim, kushte të papranueshme të punës dhe formës të dhunës, rëndom kundër grave të punësuar.

Është shkelur në mënyrë flagrante e drejta e respektimit të jetës private dhe familjare, e parashikuar nga neni 8 i KEDNJ-së.

Së fundmi, veprimet e titullares së institucionit janë konkrete dhe të pandalshme gjatë gjithë kësaj kohe, duke nisur me kërkesën për tërheqje nga kandidimi për komisionere, verifikimi i raportit mjekësor dhe kërcënimi se do të bëhet në vijimësi, dhënia e masës disiplinore “vërejtje” në shkelje të parashikimeve ligjore, si dhe cenimi në vijimësi i të drejtave si punonjëse e institucionit, duke çuar edhe në largimin nga shërbimi civil”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rregullimin e pasojave.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: *“‘Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”*.

Në bazë të nenit 7, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Vendimmarrja e KMD-së arsyetohet dhe argumentohet mbështetur në bazueshmërinë e provave e fakteve në gjykim. Kjo, pasi një moment kyç në gjykimin administrativ është edhe procesi i provueshmërisë mbi faktet objekt verifikimi, gjykimi, mbi të cilat bazohet një vendimmarrje e drejtë.

Faktet që janë objekt i të provuarit merren për bazë për efekt provueshmërie, vetëm kur ato janë paraqitur me saktësi dhe në formën e kërkuar nga ligji gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës. Për të formuar bindjen e tij, organi administrativ, në këtë rast Komisioneri, duhet të marrë parasysh si argumentet që flasin për ekzistencën e një fakti, ashtu dhe argumentet që flasin për mosekzistencën e tij.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta në nenin 18, si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: *“Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”*, si dhe *“Vetëm në raste përjashtimore dhe*

për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë³”

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, ndërkohë që Protokolli 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet. Sipas GJEDNJ, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çënohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve objektivisht e ndryshme.

Në thelb të diskriminimit, është trajtimi i diferencuar dhe më pak i favorshëm, i shfaqur qoftë në formën e *dallimit*, *kufizimit*, *përrjashtimit* ose *preferencës* dhe që ka për bazë një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji. Pra, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Duke mbajtur në konsideratë standardet dhe parashikimet e mësipërme ligjore, Komisioneri vlerëson se, ankuesja ka ngritur pretendime për trajtim të padrejtë e të pafavorshëm nga ana e Avokatit të Popullit, duke pretenduar se është gjendur në një situatë diskriminuese, situatë e cila supozohet se ka si shkak kandidimin e saj për pozicionin si komisionere.

Në kuptim të Manualit mbi ligjin Evropian të mosdiskriminimit, “*Një “shkak i mbrojtur” është një karakteristikë e një individi që nuk duhet të konsiderohet e lidhur me trajtimin e ndryshëm ose gëzimin e një përfitimi të caktuar⁴”.*

Në kuptim të LMD-së, “*Shkak i mbrojtur është një karakteristikë e identifikueshme, objektive apo personale, ose “status”, nga të cilat individët ose grupet e individëve janë të dallueshëm nga njëri-tjetri⁵”.*

Lidhur me sa më lart, si dhe me shpjegimet që jep ankuesja se është diskriminuar për shkak se ka kandiduar për pozicionin si komisionere, Komisioneri, vlerëson se, kandidimi për një pozicion

³ Shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4, datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese.

⁴ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, faqe 161.

⁵ <https://www.kmd.al/shkaqet-e-diskriminimit/>

është një veprim i bërë nga ankuesja për karrierën e saj profesionale dhe se kandidimi në vetvete, nuk përbën një “shkak të mbrojtur” sipas LMD-së, në kuptimin që t’i kenë dhënë ankueses një “status” apo t’i ketë veshur asaj cilësi personale apo karakteristika të identifikueshme, të dallueshme individuale.

Referuar përmbajtjes së nenit 1, të Ligjit 10221/2010, rezulton e qartë dhe evidente, që të gjitha shkaqet e përmendura, lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me cilësi, apo karakteristika individuale të personave që pretendojnë për diskriminim. Situata diskriminuese në vetvete është gjithmonë e lidhur me një veçori individuale të viktimës dhe në rastin konkret, ankuesja nuk ka identifikuar një shkak të vlefshëm diskriminimi, që të ketë lidhje me një nga karakteristikat e saj personale apo të një grupi të veçantë.

Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit, bashkëlidhur ankesës, rezulton se ankuesja ka aplikuar për dy nga pozicionet “Komisioner” në institucionin e Avokatit të Popullit dhe në përfundim të procesit të vlerësimit të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve ligjore nga kandidatët, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të tyre (përfshi dhe intervistimin) nga Komisioni Ad-Hoc, F.Z, është vlerësuar në mënyrë unanime nga Komisioni, dhe emri i saj i është përcjellë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si kandidate për dy pozicione si Komisioner. Pra, nga ana e institucionit⁶ dhe nga E.B, si Kryetare e Komisionit Ad-Hoc⁷, nuk ka pasur asnjë pengesë për kandidimin dhe kualifikimin e ankueses për pozicionin si Komisionere, për më tepër që njoftimi për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve për dy pozicionet “Komisioner”, është bërë që në datë 09.03.2023.

Për rrjedhojë, Komisioneri nuk vëren që të ketë pasur ndonjë konflikt mes institucionit dhe ankueses, në lidhje me kandidimin e saj, që mund të ketë shërbyer si “çdo shkak tjetër”, në kuptim të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Neni 1, i këtij Ligji është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh⁸.

⁶ Referuar Urdhër nr. 199, datë 09.12.2021 “Për miratimin e Rregullores për procedurat dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për Komisioner në institucionin e Avokatit të Popullit”. Neni 8. Faza e seleksionimit paraprak. Pika 2. “Vlerësimi kryhet nga një grup pune i cili ngrihet me Urdhër të Avokatit të Popullit. Ky grup pune kryesohet nga Sekretari i Përgjithshëm i institucionit dhe në të mer pjesë nëpunësi përgjegjës për burimet njerëzore në institucion dhe dy punonjës të tjerë të institucionit të caktuar nga titullari”.

⁷ Referuar Urdhër nr. 199, datë 09.12.2021 “Për miratimin e Rregullores për procedurat dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për Komisioner në institucionin e Avokatit të Popullit”. Neni 10. Komisioni Ad-hoc. Pika 2. “Komisioni përbëhet nga 5 anëtarë, kryesohet nga Avokati i Popullit dhe ka në përbërje përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile apo mbrojtës të të drejtave të njeriut, të përzgjedhur sips nenit 11 të kësaj rregulloreve”.

⁸ Neni 14, I KEDNJ-së: “Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”.

Në mungesë të një praktike kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14, i Konventës. I njëjti arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes “*me çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se “viktima” e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme, pikërisht për shkak të një karakteristike të saj që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”, të cilën ankuesja nuk arriti ta provonte e dokumentonte se e posedonte atë.

Bazuar në përkufizimin që ligji i bën diskriminimit, jo çdo sjellje e kundërshtuar për paligjshmëri apo trajtim të pabarabartë, është një sjellje diskriminuese. Një sjellje diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo sjellje e paligjshme konsiderohet diskriminuese.

Për sa më sipër, referuar nenit 33/4/ç, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, i cili citon se: “*Ankesa nuk pranohet nëse:, ç) ... është haptazi e pabazuar*”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj⁹.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 4/ç, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar,

⁹ Për analogji citojmë vendimet: nr. 21, datë 21.02.2020, nr. 283, datë 19.11.2024 dhe nr. 84, datë 14.04.2025, të KMD-së.

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 139, datë 05.06.2025, të subjektit ankues F.Z, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA